

**VENDIM**  
**Nr. 593, datë 31.8.2016**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES  
TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohen individët e renditur në shkronjën “a”, të shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, sipas listës së konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSO-NAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË  
TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT  
(LISTA E OKB-së)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANI-  
ZATAT ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA**

a) Lista e shtuar në **“Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”;**

1. ASLAN; AVGAZAROVICH; BYUTU-KAEV
2. AYRAT; NASIMOVICH; VAKHITOV

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personat emrat e së cilëve janë radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.